VENDIM
Nr. 177, datë 14.11.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "SMART WATT" SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ANA E ERE-s, PËR SHITJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË "SMART WATT" SHPK TE SHOQËRIA "ETS" SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 6.2, të "Licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike" miratuar me vendimin e ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, si dhe nenit 15, të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 14.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nr. 102/1-1 prot., datë 13.112019, për kërkesën e shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për shitjen e kuotave të shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k. te shoqëria "ETS" sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria "SMART WATT" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 542 prot., datë 10.9.2019, ka përcjellë në ERE njoftimin për ndryshimin e pronarit të shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k., si dhe ka kërkuar nga ERE-ja miratimin e transferimit të aksioneve të ortakut kryesor të shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k., te shoqëria "ETS" sh.p.k.

- Me qëllim saktësimin e kësaj kërkese, ERE-ja me shkresën nr. 542/1 prot., datë 26.9.2019, iu drejtua shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k. duke i bërë me dije se ERE lëshon autorizime për kryerjen e shitjes së kuotave në rastin e ndryshimit të ortakut kryesor të saj.

- Në përgjigje të shkresës së ERE-s, shoqëria "SMART WATT" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 542/2 prot., datë 16.10.2019, përcolli saktësimin e kërkesës së saj duke kërkuar dhënien e autorizimit nga ERE-ja për kryerjen e shitjes së aksioneve nga shoqëria "SMART WATT" sh.p.k., te shoqëria "ETS" sh.p.k.

- Shoqëria "SMART WATT" sh.p.k. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe mbështetur në ligjin nr. 9901, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për shkak të formës së organizimit të saj, pavarësisht pasaktësisë së kërkesës së aplikuesit, në kuptim të kësaj vendimmarrje i referohemi Ortakut dhe Kuotave.

- Shoqëria "SMART WATT" sh.p.k., ka përcjellë edhe dy shkresa të MIE-s me nr. 4146/4 prot., datë 27.8.2019, me anë të të cilave Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) i ka miratuar transferimin e së drejtës së ndërtimit të dhënë me Miratimin Përfundimtar nr. 5864/11 prot., datë 14.11.2018, si dhe transferimin e të gjithë të drejtave dhe detyrimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi nga shoqëria "SMART WATT" sh.p.k., te shoqëria "ETS" sh.p.k.,

- Me shkresën nr. 4146/6 prot., datë 14.10.2019, MIE shprehet për revokimin e transferimit të së drejtës së ndërtimit nga shoqëria "SMART WATT" sh.p.k., te shoqëria ETS sh.p.k., për shkak se vetë shoqëria "SMART WATT" sh.p.k., i ka kërkuar MIE-s të korrigjojë/revokojë shkresën me nr. 4146/4 prot., datë 27.8.2019, në mënyrë që të mundësohet miratimi i kalimit të plotë të aksioneve të shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k., te shoqëria "ETS" sh.p.k.

- MIE, në bazë të kërkesës së shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k. nr. 4146/5 prot., datë 30.9.2019, ka revokuar transferimin e të drejtës së ndërtimit. Në këtë korrespondencë MIE shprehet se: "...sa i përket transferimit të kuotave (aksioneve) nga një shoqëri te tjetra, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, ky transferim nuk ka nevojë për miratim nga MIE...".

- Shoqëria "SMART WATT" sh.p.k. është mbajtëse e licencës me nr. 440, seria P19, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 72, datë 10.5.2019. Objekt i veprimtarisë së "SMART WATT" sh.p.k. është kryerja e aktivitetit të importit, eksportit, tregtimit dhe furnizimit me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndërtimin e impianteve të energjisë së rinovueshme, prodhim të

energjisë, studim dhe konsulencë në aktivitetin e energjisë elektrike. Kryerja e çdo aktiviteti të lejuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

- Kjo kërkesë vjen në zbatim të pikës 6.2, të Licencës së Prodhimit të Energjisë Elektrike.

- Sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve, që shoqëria "SMART WATT" sh.p.k. ka depozituar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 542/3, datë 28.10.2019, rezulton se ka miratuar shitjen e kuotave në pjesëmarrje në masën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k., që zotëron ortaku i vetëm i shoqërisë, te blerësi, shoqëria "ETS" sh.p.k.

- Në lidhje me transferimin e kuotave të shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k., MIE, duke mbajtur në konsideratë parashikimin e nenit 16, "Kufizimet", të kontratës nr. 6380, datë 31.12.2018 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik 'SMART WATT' sh.p.k. me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Topojë, qarku Fier", shprehet se: "...sa i përket transferimit të kuotave (aksioneve) nga një shoqëri te tjetra, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, ky transferim nuk ka nevojë për miratim nga MIE...".

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit për shitjen e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k. që zotëron ortaku z. Endrit Beqaj, te blerësi, shoqëria "ETS" sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti